

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaFiber® P/P 6 mm

FIBRA POLIPROPILENI PËR BETON DHE LLAÇ



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaFiber® P/P 6 mm janë fibra polipropilene përpunimi special.

PËRDORIMET

SikaFiber® P/P 6 mm ofrohen në qese gati për përzjerje në beton dhe në llaç. Produkti disponohet gjithashtu në ambalazh edhe më të madh për raste konsumimi më të madh. SikaFiber® P/P 6 mm përdoren për:

- Pllaka të mëdha dhe sipërfaqe të mëdha betoni
- Beton dhe llaçe që mund të jenë subjekt i goditjeve të forta
- Llaçe dhe betone që kërkojnë kohezion të lartë gjatë hedhjes, si në rastet e zonave të pjerrëta ose në rastet e elementeve të parapërgatitura
- Shtresa të holla betoni të spërkatur (shotcrete)
- Elemente të parafabrikuara për përmirësimin e rezistencës së kulmeve, qosheve, etj.
- Suvatime, gipse etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

SikaFiber® P/P 6 mm për shkak të procesit të posaçëm të prodhimit të tyre janë lehtësisht të tretshme në brumin e llaçit të freskët, duke prodhuar kështu një rrjetë shumë të dendur e cila ndikon në:

- Reduktimin e plasaritjeve gjatë tkurrjes
- Përmirësimin e rezistencës ndaj goditjeve dhe papërshkueshmërisë së pastës së ngurtësuar të çimentos në beton dhe llaç

Fibrat nuk zëvendësojnë armimin statik, por mund të zëvendësojnë armimin kundër plasaritjeve.

MIRATIME / STANDARDE

Fibra polipropilene, Kategoria Ia, gjatësia 6mm, për përdorim në beton dhe llaç në përputhje me EN14889-2:2006, Deklaratë Performance 85591038 dhe mbart markimin CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Polipropilene
Ambalazhi	Qese 600 gr në kuti kartoni Furnizim rifuxho në kuti kartoni 25kg
Paraqitja / Ngjyra	Fibra, të bardha
Jetëgjatësia	60 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhen në ambalazhin origjinal dhe të pahapur, të mbrojtura nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, lagështia dhe ngrica.
Dendësia	0.91 gr/cm ³
Përmasat	Gjatësia: 6mm

TË DHËNA TEKNIKE

Udhëzime për betonimin

Duhet të zbatohen rregullat standarde të betonimit për sa i përket prodhimit dhe vendosjes së betonit. Referohuni tek standardet përkatëse. Betoni i freskët duhet të maturohet në mënyrë të përshtatshme.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar

Të paktën 600 gr SikaFiber® P/P 6 mm / m³ betoni ose llaçi

Kompatibiliteti

SikaFiber® P/P 6 mm mund të kombinohet me shumë produkte nga gama e produkteve Sika:
- Superplastifikatorët Sika® Plastiment®/ Sikament® / Sika® ViscoCrete®
- Të gjithë aditivët e posaçëm të betonit
- Të gjithë aditivët e llaçit
Për çdo rast, rekomandohet kryerja e testimeve përpara kombinimit të produkteve.

Mënyra e aplikimit

SikaFiber® P/P 6 mm shtohen përzjerjen e freskët të betonit. Shtoni sasinë e nevojshme të qeseve brenda betonieres, në varësi të sasisë së përzjerjes. Përzieni plotësisht për 2 – 6 minuta.

KUFIZIME

- Përdorimi i SikaFiber® P/P 6 mm duhet bërë bazuar mbi një recetë të miratuar dhe duke testuar burimin e materialeve vendase.
- Përdorni fibra me gjatësi 18 mm në rast përmase agregati > 10 mm.
- Përdorni fibra me gjatësi 6 ose 12 mm në rast përmase agregati < 10 mm.
- Në rast agregatesh me madhësi < 6 mm, hidhini fibrat me dorë brenda përzjerjes.
- Përpara aplikimit duhet të kryhen testime përshtatshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaFiber® P/P 6 mm

Shkurt 2019, Botimi 01.01

021408021010000083

SikaFiberPP6mm-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf